

# AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

## “Gold Car Albania ”

Ne baze te ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Per shoqerite tregtare”, me vullnetin e tyre te lire te shprehur me nenshkrimin e ketij Akti, sot me date 21.10.2024 Themeluesit:

1. **Skerdian Kacuqi**, lindur në Durres, Shqiperi me 29.07.1990 me nr. Personal J00729066M

Deklarojne se kane vendosur të nënshkruajne këtë kontratë themelimi për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë refereruar si Shoqëria), aktiviteti i së cilës rregullohet nga Akti i Themelimit dhe Statuti duke respektuar edhe kërkesat e legjislacionit shqiptar për shoqëritë tregtare.

### **Neni 1-Emertimi**

Emertimi i shoqërisë është

### **“Gold Car Albania”**

Emri tregtar i shoqërisë : **“Gold Car Albania”**

Ne të gjitha aktet e dokumentat që dalin nga shoqëria emertimi i saj do të paraprihet (ose do të ndiqet menjëherë) nga inicialet “SH.P.K” dhe nga shpallja e kapitalit themeltar.

### **Neni 2-Vendndodhja e selisë**

Selia zyrtare e shoqërisë ndodhet:

Durres, Lagjia 17, Rr. Sorra, Nr. Pasurie 5/259+1-18, Zone Kadastrale 8513.



### **Neni 3- Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë pa afat, duke filluar prej datës së rregjistrimit të saj në Qendren Kombëtare të Rregjistrimit.

### **Neni 4- Objekti i veprimtarisë**

- Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është si vijon:

#### **Në fushën e tregtisë shoqëria do të kryejë:**

- Agjensi e makinave me qera dhe automjeteve të ndryshme. Agjensi organizimi eventesh dhe panairesh. Agjensi sigurimesh. Agjensi transporti brenda dhe jashtë vendit për udhëtarët. Shërbime taksi. Shërbim karrotreci. Blerje dhe shitje automjeteve dhe produkteve të lidhura me to.

### **Neni 5- Kapitali Themeltar**

**Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (Njëqind mijë ) leke.**

Kapitali përbehet nga 1 (një) kuote me vlerë 100.000 (Njëqind mijë) leke, të shlyera në masë 100% nga Ortakët themelues. Ai mund të zmadhohet dhe të zvogëlohet me vendim të Ortakëve sipas normave të fushës në fuqi.

### **Neni 6-Kontributet dhe pjesët e kapitalit themeltar**



**Kapitali themeltar i shoqërise është 100.000 (Njeqind mije) leke i cili perbehet nga 1 (nje) kuote perkatesisht:**

1. **Skerdian Kacuqi**, lindur në Durrës, Shqipëri me 29.07.1990, me nr. personal, vlera e kapitalit te pergjithshem **100.000** Leke, numri i pjeseve 1, qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqërise.

Pjeset e kapitalit themeltar nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlere te tregtueshme dhe as me kontribute ne sherbime.

Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqërise perkundrejt te tretteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqërise

#### **Neni 7- Transferimi i pjesëve të kapitalit**

1. Pjesët e kapitalit janë të transferueshme ndaj të tretëve sipas procedurave të parashikuara nga Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare" dhe nga statuti i shoqërisë.

#### **Neni 8- Administrimi**

1. Shoqëria administrohet nga një ose disa administrator, qofshin këta edhe jo ortak, të cilët emërohen ose shkarkohen nga Asambleja e Zakonshme.
2. Administratori është përfaqësuesi ligjor i shoqërisë. Ai ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët, në interes të shoqërisë, dhe në emër të saj në të gjitha rrethanat që kanë lidhje me objektin e Shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji apo Statuti ja jep Asamblesë së Ortakëve.
3. Eshte vendosur administrim i perbashket nga palet :

**Skerdian Kacuqi**, lindur në Durrës me 29.07.1990, me nr. Personal J00729066M, me afat 5- vjecar deri me 21.10. 2029 me te drejt rizgjedhje.

Të gjitha shpenzimet, taksat dhe honoraret e paguara për këtë akt dhe aktet që rrjedhin prej tij u përkasin bashkarisht dhe solidarisht nënshkruesëve në përpjestim me kontributet e tyre deri sa shoqëria të rregjistrohet në rregjistrin tregtar.

#### **Neni 9- Të tjera**

1. Shoqëria do ta ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi.



**Neni - 10**

1. Të gjitha kundërshtimet ose mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë funksionimit të shoqërisë ose gjatë likuidimit të saj midis ortakëve ose një ose më shumë ortakëve dhe Shoqërisë do të diskutohen në menyre të drjetpërdrejtë midis të interesuarëve për ti zgjidhur me pajtim. Në rast të kundërt i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave kompetente në kushtet e parashikuara nga legjislacioni Shqiptar në fuqi.

**Neni - 11**

1. Ky Akt Themelimi është përgatitur në katër kopje të barabarta dhe të barazvlefshme.

*Parë dhe miratuar në Durres , më 21.10.2024*

**ORTAKET E SHOQERISE**

**Skerdian Kacuqi**

*Skerdian Kacuqi*